

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**LIGJI nr. 02/L-109**

**PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE**

Kuvendi i Kosovës

Në bazë të kreut 5.1(ë) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovës,

**Miraton:**

**LIGJIN PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE**

**Kapitulli I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi i ligjit**

Me këtë ligj përcaktohen sëmundjet ngjitëse si dhe rregullohen aktivitetet për zbulimin në kohë, evidencimin e shfaqjes, parandalimin, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Për qëllimet e këtij ligji vlejné përkufizimet si vijon:

**Sëmundja ngjitëse**- Sëmundja e cila shkaktohet nga mikroorganizma dhe parazitë sëmundjeshkaktues që barten drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga njeriu i sëmurë ose bartësi i shkaktarit tek njeriu i shëndoshë dhe nga kafshët e prodhimet blegtorale tek njerëzit.

**Njeriu i sëmurë**– person i prekur nga ndonjë sëmundje ngjitëse.

**Mikrobbartës** personi apo kafsha që strehon dhe tajon shkaktarët e sëmundjes ngjitëse në mungesë të shenjave klinike të sëmundjes dhe shërben si burim potencial i infeksionit.

**Infeksion** – depërtimi dhe shumimi i shkaktarë të ndryshëm mikrobik në organizmin e njeriut, pa zhvillim të pasqyrës klinike të sëmundjes ngjitëse.

**Inkubacion** – Intervali kohor prej futjes së mikroorganizmave në organizmin e njeriut deri te paraqitja e shenjave të sëmundjes.

**Antropozonozë (zoonozë)**– sëmundje ngjitëse të kafshëve të cilat në rrethana të veçanta prekin organizmin e njeriut.

**Vatër infeksioni**– është territor që karakterizohet me praninë e burimit të infeksionit (njeriun apo kafshën) dhe faktorët favorizues të mjedisit jetësor për përhapjen e infeksionit.

**Sporadiciteti**– paraqitje e rasteve të sëmundjeve ngjitëse të cilat nuk kanë lidhje në kohë dhe territor.

**Epidemia**– paraqitja e dy e më shumë rasteve të sëmundjeve ngjitëse të lidhura në kohë dhe territor apo rritje enorme e numrit të rasteve të sëmundjes.

**Endemia**– prania konstante e sëmundjes ngjitëse ose agjensit infektiv në një rajon të caktuar gjeografik ose në popullatë që në rrethana të veçanta shpërthen në epidemi.

**Pandemia** – përhapja masive e sëmundjes ngjitëse e cila i tejkalon kufijtë e një shteti duke përfshirë disa shtete apo edhe kontinente.

**Izolimi** – masë kundërepidemike, qëllimi i të cilit është ndarja e personave të infektuar nga ata të shëndoshë për të penguar përhapjen e infeksionit

**Karantina** - kufizim i lirisë së lëvizjes së njerëzve të shëndoshë të cilët janë ekspozuar shkaktarëve të rrezikshëm të sëmundjeve ngjitëse

**Dezinfektim** – asgjësim i agjensëve infektiv jashtë organizmit të njeriut, përmes metodave mekanike, fizike dhe kimike.

**Dezinsektim** – asgjësim i vektorëve (insekteve) bartës të shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse me metodat fizike, kimike dhe biologjike.

**Deratizim** – asgjësim i brejtësve bartës të shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse me metodat mekanike, kimike dhe biologjike.

**Paraqitja e sëmundjeve ngjitëse** – njoftim i autoriteteve shëndetësore përkatëse me rastin e paraqitjes së sëmundjes ngjitëse

**Mbikëqyrja** – është grumbullimi dhe evidentimi i vazhdueshëm i të dhënave, përpunim, analizë dhe interpretim i tyre.

**Profilaksa** – parandalim i paraqitjes së sëmundjes ngjitëse përmes vaksinave, serumeve dhe barnave.

**Imunoprofilaksa** – parandalimi i sëmundjes ngjitëse përmes vaksinave

**Vaksina** – preparat imunobiologjik që përmban shkaktarët e sëmundjes ngjitëse që pas injektimit nxisin prodhimin e antitruptave

**Seroprofilaksa** - parandalimi i sëmundjes ngjitëse përmes serumeve

**Serumi** – preparat imunobiologjik që përmban antitruptat të gatshëm

**Kimiprofilaksa** - parandalimi i sëmundjes ngjitëse përmes barnave

**ISK**-Inspektorati Sanitar i Kosovës.

**IKSHPK**– Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

## Kapitulli II

### Neni 3

3.1 Sëmundjet ngjitëse në kuptim të këtij ligji ku parandalimi dhe pengimi i tyre është në interes për vendin janë :

<b>Lista</b>	
<b>e sëmundjeve ngjitëse (sipas KNS 10)</b>	
A00	Kolera
A01	Ethet iroide dhe paratifoide
A02	Salmonellozat tjera
A03	Shigellozat
A04	Infeksionet tjera bakteriale të zorrëve
A04.0– A04.4	Infeksionet me E.Coli
A04.5	Infeksionet e zorrëve me Campylobacter
A04.6	Infeksionet e zorrëve me Yersinia enterocolitica
A04.9	Infeksionet bakteriale të zorrëve të paspecifikuara
A05	Infeksionet tjera bakteriale me ushqim
A06	Amebiaza
A07	Sëmundjet tjera të zorrëve me protozoa
A08	Infeksionet virale dhe infeksionet e tjera specifike të zorrëve
A09	Diarreja dhe gastroenteritet
A15–A19	Tuberkulozi i traktit respirator, e konfirmuar bakteriologjikisht dhe histologjikisht
A20	Murtaja
A21	Tularemia
A22	Antraksi
A23	Bruceloza
A24	Malleusi dhe melioidoza
A25	Ethet pas kafshimit të miut
A26	Erisipeloidi
A27	Leptospiroza
A28	Sëmundjet tjera bakteriale zoonotike, të pa klasifikuara
A30	Lepra
A31	Infeksionet tjera mikobakteriale
A32	Listerioza
A33–A35	Tetanus
A36	Difteria
A37	Kolla e bardhë
A38	Skarlatina
A39	Infeksionet meningokoksike
A40	Septikemia streptokoksike
A41	Septikemitë tjera
A42	Aktinomikoza
A43	Nokardioza
A44	Bartonelloza
A46	Erizipella

A48	Sëmundjet tjera bakteriale të paspecifikuara
A48.1	Legionelloza
A49	Infeksioni bakterial i pjesëve të paspecifikuara
A50	Sifilizi kongjenital
A51	Sifilizi i hershëm
A52	Sifilizi i vonshëm
A53	Sifilizët tjerë dhe të paspecifikuar
A54	Infeksioni gonokoksik
A55	Limfogranuloma venerike
A56	Sëmundjet tjera klamidiale të përcjella në mënyrë seksuale
A57	Shankroidi
A58	Granuloma inguinale
A59	Trihomoniaza
A60	Infeksioni viral herpetik i regjionit anogjenital
A63	Sëmundjet tjera të përcjella kryesisht në mënyrë seksuale, të pa klasifikuara
A64	Sëmundjet e paspecifikuara të përcjella në mënyrë seksuale
A65	Sifilizi jovenerik
A66	Frambezia
A67	Pinta
A68	Ethet rekurrente
A69	Infeksionet tjera spiroketale
A69.2	Sëmundja e Lajm
A70	Infeksioni klamidial-klamidiaz-klamidia iroid, ornitoza, psitakoza, ethet iroid
A71	Trakoma
A74	Sëmundjet tjera të shkaktuara nga klamidiet
A75	Ethet iroide që barten përmes marrave
A77	Ethet ekzantematike që barten përmes rriqrave
A78	Ethet Q
A79	Rikeciozat tjera
A80	Paraliza akute e fëmijëve
A82	Tërbimi
A81	Infeksionet tjera të ngadalshme SNQ të shkaktuara nga virusët
A83	Encefaliti viral i bartur përmes mushkonjave
A84	Encefaliti viral i bartur përmes rriqrave
A85	Encefalitet tjera virale, të pa klasifikuara
A86	Encefaliti viral i paspecifikuar
A87	Meningjiti viral
A88	Infeksionet tjera virale të SNQ
A90	Ethet denge
A91	Ethet denge hemorragjike
A92	Ethet tjera virale të bartura me mushkonja
A93	Ethet tjera virale të bartura me

	insekte, ethet papataçi
A94	Ethet tjera virale të paspecifikuara të bartura me artropode
A95	Ethet e verdha
A96	Ethet hemorragjike të shkaktuara me arenavirus
A98	Ethet tjera hemorragjike virale, Crime Congo, Sindromë renale, Ebola, Marbourg,
A99	Ethet virale hemorragjike jo specifike
B00	Infeksionet virale me herpes
B01	Variçella
B02	Herpes zosteri
B03	Variola vera
B05	Fruthi
B06	Rubella
B07	Veruket virale
B08	Infeksionet tjera virale me dëmtim të lëkurës dhe mukozës (moluscum contagiosum)
B15	Hepatiti viral akut A
B16	Hepatiti viral akut B
B17	Hepatitet akute tjera të shkaktuara me virus, hepatiti C, E
B18	Hepatiti viral kronik
B19	Hepatiti viral I paspecifikuar
B20 – B24	HIV infeksioni, AIDS
B25	Virozat me cytomegalovirus
B26	Parotiti
B27	Mononukleozë infektive
B30	Konjuktiviti viral
B33	Sëmundjet tjera virale, Karditi viral, Poliartiritet epidemike
B34	Adenovirozat
B35	Dermatofitoza
B36	Mikozat tjera sipërfaqësore
B37	Kandidiaza
B38	Kokcidioidomikoza
B39	Histoplazmoza
B40	Blastomikoza
B41	Parakokcidioidomikoza
B42	Sporotrikoza
B43	Kromomikoza dhe abscesi feomikotik
B44	Aspergilloza
B45	Kriptokokoza
B46	Zigomikoza
B47	Micetoma
B48	Mikozat e tjera
B49	Mikozat e paspecifikuara
B50	Malaria me plazmodium falciparum
B51	Malaria me plazmodium vivaks
B52	Malaria me plazmodium malaria
B53	Malariat tjera të konfirmuara në laborator
B54	Malaria e paspecifikuar

B55	Leishmaniaza
B56	Tripanozomiaza Afrikane
B57	Sëmundja Chagas
B58	Toksoplazmoza
B59	Pneumocistoza
B60	Sëmundjet tjera të shkaktuara me protozoa
B64	Sëmundjet protozoare jo të specifikuar
B65	Shistozomiaza
B66	Infeksionet tjera me trematode
B67	Ekinokokoza
B68	Teniaza
B69	Cisticerkoza
B70	Difilobotriaza dhe sparganoza
B71	Infeksionet tjera me cestode
B72	Drakunkuliaza
B73	Onkocerkiaza
B74	Filariaza
B75	Trikinelloza
B76	Ankilostomiaza
B77	Askariaza
B78	Strongiloidiaza
B79	Trihuriaza
B80	Enterobiaza
B81	Helmintiazat tjera të zorrëve të pa klasifikuar
B82	Parazitizat e zorrëve të paspecifikuar
B83	Helmintiazat tjera
B85	Pedikuloza dhe ftiriaza
B86	Zgjebja
B87	Miaza
B88	Infestimet lëkurore nga artropodet
B89	Sëmundjet parazitare të paspecifikuar
B90	Sekuella e tuberkulozit
B91	Sekuella e paralizës së fëmijëve
B92	Sekuella e lepers
B94	Sekuella e sëmundjeve tjera infektive dhe parazitare të paspecifikuar
B95	Streptokoku dhe stafilokoku si shkaktarë të sëmundjeve
B96.3	Haemophilus Influenzae
B97	Virusët si shkaktarë të sëmundjeve
B99	Sëmundjet tjera ngjitëse dhe të paspecifikuar
G00	Meningjiti viral
J10–J11	Gripi (përfshirë gripin e shpendëve)
J12–J15, J84	Pneumonitë virale dhe bakteriale (përfshirë SARS-in)
P35	Infeksionet virale kongjenitale
P35.0	Rubella kongjenitale
P35.1	Infeksioni kongjenital me Citomegalovirus

3.2 Po qe se paraqitet rreziku nga sëmundjet ngjitëse, të cilat nuk gjenden në listën nga paragrafi 1 i këtij neni e që mund të rrezikojnë tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë, në propozim të IKSHPK përcakton masat profilaktike dhe kundërepidemike, të përshkruara me këtë ligj, masat tjera në mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse dhe masat e përshkruar si të obliguara sipas konventave ndërkombëtare shëndetësore dhe aktet tjera ndërkombëtare.

#### Neni 4

4.1 Mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin është detyrë e IKSHPK-së, Inspektoratit Sanitar të Kosovës, Inspektoratit Shëndetësorë të Kosovës, të gjithave institucioneve shëndetësore publike dhe private, institucioneve jo shëndetësore, komunave dhe vet qytetarëve nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë.

4.2 Masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse drejtpërdrejt i zbatojnë institucionet shëndetësore dhe profesionistët shëndetësorë konform këtij ligji.

#### Neni 5

Mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse përfshin planifikimin, programimin, organizimin, zbatimin e masave për parandalimin, luftimin, eliminimin, çrrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse si dhe sigurimin e mjeteve materiale dhe të tjera, e cila ka prioritet në krahasim me masat tjera të mbrojtës shëndetësore.

#### Neni 6

6.1 Masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse që mund të kalojnë nga kafshët në njerëz, i zbatojnë institucionet shëndetësore, ISK në bashkëpunim me institucionet veterinarë që kanë të bëjnë me njoftimin reciprok për shfaqjen dhe përhapjen e këtyre sëmundjeve dhe me organizimin e zbatimit të masave kundërepizootike, kundërepidemike, higjienike dhe masave tjera për parandalimin, përkatësisht luftimin e sëmundjeve të veçanta sipas dispozitave të këtij ligji dhe Ligjit për inspektoratin sanitar të Kosovës Nr. 2003/22.

6.2 IKSHPK hulumton, studion dhe analizon situatën epidemiologjike të vendit dhe përcakton strategjinë për përmirësimin e vazhduar të saj.

#### Neni 7

7.1 Shpallja e epidemisë së sëmundjeve ngjitëse në Kosovë bëhet në pajtim të nenin 112. paragrafi 4 të Ligjit për Shëndetësi.

7.2 Ministria e Shëndetësisë propozon dhe kërkon nga Qeveria mbështetje financiare për raste të jashtëzakonshme epidemike në bazë të nenit 114.1, të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

7.3 Në rast të shfaqjes së ndonjëres nga sëmundjet ngjitëse të përshkruara në nenin 3. paragrafi 1 të këtij ligji, organet kompetente për zbatimin e masave parandaluese dhe trajtimin e të sëmurëve kanë të drejtë të hynë në çdo kohë në institucione shëndetësore publike e private, objekte banuese, ndërmarrje punuese, reparte ushtarake për të bërë hulumtimin epidemiologjik, izolimin, hospitalizimin, mbikëqyrjen shëndetësore të kontakteve, vaksinimin, depistimin, dezinfektimin, dezinfektim dhe deratizimin (në tekstin e mëtejshëm: DDD) dhe trajtimin profilaktik.

7.4 Kur punonjësit e mësipërm hasin në pengesa në kryerjen e detyrës kërkojnë mbështetjen e organeve të gjyqësisë, prokurorisë dhe organeve të rendit publik.

### Kapitulli III

#### MASAT PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE E NGJITËSE

##### Neni 8

8.1 Mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse është e obliguar dhe zbatohet në ndërmarrjen e masave të përgjithshme dhe të veçanta.

8.2 Masat e përgjithshme për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse janë:

- a) Sigurimi i ujit të pijshëm higjienik si dhe mbrojtja sanitare e burimeve, objekteve dhe rrjetit shpërndarës për furnizimin publik me ujë të pijshëm;
- b) Mënjanimi i ujërave të ndotura dhe hedhurinave sipas mënyrës dhe nën kushtet në të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i insekteve dhe i brejtësve ;
- c) Ruajtja e kushteve tekniko sanitare dhe higjienike në ndërtesa publike, në mjetet e komunikacionit publik dhe në vendet publike;
- d) Sigurimi i gjendjes së rregullt sanitare të artikujve ushqimorë dhe të kushteve tekniko sanitare dhe higjienike për prodhimin, qarkullimin dhe ruajtjen e tyre;
- e) Kryerja e DDD parandalues në qendrat e banuara, në hapësirat publike, objektet për furnizimin me ujë të pijshëm, në objektet dhe mjetet e komunikacionit publik, në objekte për prodhimin dhe qarkullimin e artikujve ushqimorë dhe në objekte të tjera publike;
- f) Sigurimi i sasisë së mjaftueshme të mjeteve dezinfektuese dhe të mjeteve tjera për zbatimin e masave nga pikat a) deri e), të këtij paragrafi;
- g) Informimi i drejtë, komunikimi, promovimi i shëndetit dhe edukimi i vazhdueshëm shëndetësor i personelit të organizatave shëndetësore dhe joshëndetësore si dhe i popullatës;

8.3 Masat e veçanta për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse janë :

- a) Zbulimi me kohë i burimit të infeksionit dhe i rrugëve të bartjes së infeksionit;
- b) Paraqitja e sëmundjeve ngjitëse;
- c) Izolimi dhe karantina;
- d) Transportimi;
- e) Shërimi i personave të sëmurë;
- f) DDD i obliguar;
- g) Mbikëqyrja shëndetësore e personave të punësuar dhe personave tjerë bacilmbartës;
- h) Imunoprofilaksa, seroprofilaksa dhe kimioprofilaksa;
- i) Masat tjera të përcaktuara me këtë Ligj.

##### Neni 9

9.1 Masat e përgjithshme dhe masat e veçanta për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse zbatohen në përputhje me programet vjetore, afat mesme dhe afat gjata që në kuadrin e veprimtarive dhe përgjegjësisë të veta të hartuara nga IKSHPK-ja me pëlqimin e Ministrisë së Shëndetësisë.



9.2 Në programet nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohen masat dhe caktohen implementuesit e programeve, mjetet dhe afatet për zbatimin e këtyre programeve .

#### Neni 10

Zbulimi me kohë i burimeve të infeksionit dhe rrugëve të bartjes së infeksionit

Për të zbuluar me kohë burimet e infeksionit dhe rrugët e bartjes së infeksionit, institucionet shëndetësore duhet të kryejnë:

- a) Vrojtimin dhe vëzhgimin epidemiologjik të terrenit;
- b) Huluntimi epidemiologjik-anketa epidemiologjike, për sëmundjet ngjitëse sipas nenit 3. paragrafi 1 të këtij ligji;
- c) Kontrolli shëndetësor i personave që janë trajtuar nga ethet tifoide, ethet paratifoide, dizenteria bacilare dhe salmonellozat;
- d) Ekzaminimi i pranisë së markerëve të hepatiteve B dhe C, virusit HIV dhe sifilizit, të dhënës të vullnetar të gjakut;
- e) Huluntimi dhe ekzaminimi epidemiologjik, huluntimi mikrobiologjik dhe kontrolli shëndetësorë i personave që lëngojnë ose dyshohet se vuajnë nga sëmundjet ngjitëse shkaktarë i të cilave nuk është i njohur.

#### Neni 11

11.1 Identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse me qëllim të konstatimit të diagnozës e bëjnë IKSHPK dhe institucionet shëndetësore të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë.

11.2 Verifikimin e diagnozës së sëmundjeve të veçanta ngjitëse e bënë IKSHPK.

#### Neni 12

IKSHPK i mban të dhënat për ekzaminimet laboratorike dhe jep raporte Ministria e Shëndetësisë për shkaktarët e sëmundjeve ngjitëse të veçanta, në kushtet dhe mënyrën që janë parapara me këtë ligj.

#### Neni 13

Paraqitja e sëmundjeve ngjitëse

Paraqitjes së obliguar i nënshtrohen:

- a) Çdo sëmundje ose vdekje nga ndonjë prej sëmundjeve ngjitëse të theksuara në nenin 3. paragrafi 1 të këtij ligji;
- b) Çdo dyshim që ekziston për sëmundjet: Kolera, Murtaja, Variola, Ethet e verdha, Tifoja e morrit, Ethet hemorragjike virale, SARS, Gripi i shpendëve, Fruthi, Difteria, Paraliza e fëmijëve, Ethet tifoide, Antraksi, Bruceloza, Lepra, Tërbimi, Meningjitet;
- c) Çdo ndryshim i diagnozës fillestare të sëmundjes duhet të raportohet përsëri me emërtim të ri të sëmundjes ngjitëse;
- d) Çdo epidemi e ndonjë sëmundje ngjitëse nga neni 3. paragrafi 1 i këtij ligji, dhe epidemi nga shkaktarë të panjohur;
- e) Çdo shkaktar i sëmundjes ngjitëse nga neni 3. paragrafi 1 i këtij ligji, i përcaktuar me analizë mikrobiologjike;

- f) Çdo tajim i bacileve të tifos së zorrëve, salmonellozave, dizenteria bacilare;
- g) Çdo bartje e antigjeneve të hepatitisit B dhe C, antitruptave në HIV dhe parazitëve shkaktarëve të malaries;
- h) Çdo lëndim nga ndonjë kafshë e tërbuar ose kafshë e cila dyshohet se është tërbuar;
- i) Çdo lëndim që dyshohet në plagë tetanogjene;
- j) Çdo kafshim nga gjarpërinjtë.

#### Neni 14

14.1 Nëse institucioni shëndetësor publik dhe privat konstaton sëmundjen ose vdekjen nga neni 13 pikat a) deri i), ka për detyrë që këtë ta paraqes menjëherë në IKSHPK, ISK dhe te organet tjera kompetente.

14.2 Sëmundja, dyshimin se ekziston sëmundja, lëndimin ose vdekjen e konstaton mjeku ose punëtori tjetër i shëndetësisë jashtë kryerjes së detyrës në institucionin shëndetësor, ka për detyrë që lidhur me këtë ta njoftoi menjëherë institucionin më të afërt shëndetësorë.

14.3 Paraqitja e sëmundjes ngjitëse bëhet në bazë të diagnozës klinike dhe rikonfirmohet pas diagnozës laboratorike.

#### Neni 15

15.1 Për çdo sëmundje ngjitëse nga grupi i antropozoonozave institucioni shëndetësor i cili konstaton sëmundjen ka për detyrë që ta njoftoi menjëherë IKSHPK-në dhe ISK-në.

15.2 Shërbimi veterinar është i obliguar që menjëherë të paraqes çdo sëmundje ngjitëse nga paragrafi 1 i këtij neni poqe se konstaton sëmundjen apo ngordhjen e kafshëve.

#### Neni 16

16.1 Mbikëqyrja dhe raportimi i sëmundjeve ngjitëse është obligim ligjor i të gjitha niveleve të sistemit të kujdesit shëndetësorë të Kosovës, duke filluar prej punkteve të mjekësisë familjare deri në nivelin tretësor. Të gjitha raportet nga niveli parësor dhe dytësor dërgohen në degët e IKSHPK të cilat brenda një jave i dërgojnë në IKSHPK. Niveli tretësor i kujdesit shëndetësor raporton drejtpërdrejtë në IKSHPK. IKSHPK raporton në mënyrë të rregullt në Ministrinë e Shëndetësisë.

16.2 Grupi i caktuar i sëmundjeve ngjitëse raportohet brenda 24 orëve.

16.3 Sëmundjet ngjitëse raportohen sipas formularit 1 dhe 2, të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë, me propozim të IKSHPK-së.

16.4 IKSHPK përgatit raport përmbledhës për ecurinë e paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, për të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësorë, çdo 6 muaj.

#### Neni 17

##### Izolimi, transporti dhe mjekimi

17.1 Personat për të cilët konstatohet se janë të sëmurë nga kolera, murtaja, variola vera, ethet hemorragjike virale, legjionelloza, paraliza e fëmijëve, difteria, tifoja e morrit, ethet rekurente, tifoja e zorrëve, ethet paratifoide A dhe B, bruceleza, malaria, tërbimi, tetanusi, antraksi,

meningjitet, duhet të izolohen dhe mjekohen në institucionet shëndetësore për trajtimin e sëmundjeve ngjitëse.

17.2 Të gjithë personat për të cilët dyshohet se vuajnë nga kolera, murtaja, variola vera, legjionelloza, gripi i shpendëve, SARS dhe ethet hemorragjike virale duhet patjetër të hospitalizohen në Klinikën Infektive të QKUK. Personat e sëmurë nga sëmundjet tjera ngjitëse shërohen në mënyrë spitalore ose në shtëpi, nëse për këtë ekzistojnë kushtet .

#### Neni 18

Personat që sëmuren ose për të cilët ekziston dyshimi se janë sëmurë nga sëmundjet ngjitëse nga neni 17. paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, mund të transportohen vetëm me mjete sanitare të transportit nën kushtet që e bëjnë të pa mundshme përhapjen e infektimit.

#### Neni 19

##### Dezinfektimi, dezisektimi dhe deratizimi

Është i detyrueshëm dezinfektimi i tajimeve, i gjësendeve, dhomave dhe hapësirave në të cilat ka qëndruar personi i sëmurë nga kolera, murtaja, variola vera, ethet hemorragjike virale, legjionelloza, paraliza e fëmijëve, difteria, tifoja e morrit, ethet rekurente, ethet tifoide, ethet paratifoide A dhe B, brucelloza, malaria, tërbimi, tetanusi, antraksi, meningjitet, tuberkulozi në periudhën e infektueshmërisë .

#### Neni 20

20.1 Është i detyrueshëm dezinfektimi parandalues i tajimeve, gjësendeve personale dhe sendeve tjera, pajisjeve dhe i dhomave dhe hapësirave institucioneve shëndetësore, të shkollave dhe institucioneve tjera për fëmijë dhe te rinj.

20.2 Në masat e përshkruara në nenin 8. të këtij ligji, përcaktohet mënyra e kryerjes së dezinfektimit në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 21

Është i detyrueshëm dezisektimi i personave dhe i gjësendeve personale, i hapësirave të banimit, i hapësirave tjera, dhe i mjeteve të transportit me rastin e shfaqjes së sëmundjeve: kolera, murtaja, ethet hemorogjike virale, legjionelloza, tifoja e morrit, ethet rekurente, tifoja e zorrëve, ethet paratifoide A dhe B, burceloza, malaria dhe meningjitet.

#### Neni 22

Është i detyrueshëm deratizimi në qendrat e banimit, në aeroporte, në mjetet e tjera të komunikacionit publik, në depot dhe në lokalet tjera të punës, në rast të shfaqjes ose të rrezikut nga murtaja, leptospiroza, ethet hemorragjike virale, tularemia apo të sëmundjeve tjera ngjitëse ku burimi i infektimit janë brejtësit.

## Neni 23

23.1 DDD mund të kryhen vetëm me preparate, efikasiteti i të cilëve është dëshmuar. Mënyra e aplikimit e tyre duhet t'i përmbush kriteret për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

23.2 DDD, të përshkruara nga paragrafi 1 i këtij neni, mund ta kryejnë edhe institucionet e specializuara nën mbikëqyrjen e ISK dhe në bazë të mendimit profesionale-shkencore nga IKSHPK-së.

23.3 Konstatimi i efikasitetit të mjeteve për qëllimet nga paragrafi 1 i këtij neni, kryhet në bazë të ekzaminimit: kimik, fizik dhe biologjik të preparateve nga institucionet kompetente.

## Neni 24

### Mbikëqyrja shëndetësore ndaj personave në prodhimin dhe qarkullimin e artikujve ushqimor

Nën mbikëqyrjen shëndetësore për të parandaluar sëmundjet ngjitëse vihen:

- a) Personat që punojnë në prodhimin ose qarkullimin e artikujve ushqimorë apo që punojnë në furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm, të cilët në punët dhe detyrat e veta të punës vijnë në kontakt të drejtpërdrejt me artikujt ushqimorë, përkatësisht me ujin e pijshëm;
- b) Personat e zënë me punë në Institucionet parashkollore dhe çerdhet e fëmijëve;
- c) Personat të cilët në institucionet shëndetësore merren me kontrollin, mjekimin, trajtimin dhe kujdesin ndaj të sëmurëve dhe personat që punojnë në prodhime, me pajisjen dhe dhënien e medikamenteve;
- d) Personat që punojnë në prodhimin, qarkullimin dhe dhënien e barnave ose që në mënyrë tjetër gjatë punës vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me barnat;
- e) Personat të cilët punojnë në institucione dhe në objektet për dhënien e kujdesit higjienik të popullsisë: në banja publike, në rrojtore, në sallonin e frizerëve, në sallonin kozmetik si dhe personat të cilët punojnë në prodhimin ose qarkullimin e preparateve kozmetike;
- f) Personat të cilët vijnë në Kosovë nga vendet endemike me sëmundjet ngjitëse trajtohen sipas konventave ndërkombëtare shëndetësore.

## Neni 25

25.1 Mbikëqyrja shëndetësore përfshin kontrollin shëndetësor të personave para se të fillojnë të ushtrjnë ndonjë veprimtari të caktuar të përshkruara në nenin 24. të këtij ligji.

25.2 Kontrolli shëndetësor i zbulimit të bacilmbartësve nga neni 24. paragrafi 1 i këtij ligji, bëhet çdo gjashtë muaj.

25.3 Kontrolli shëndetësor i personave nga neni 24. pikat b) deri e) të këtij ligji, bëhet një herë në vit.

25.4 Kontrolli shëndetësor i këtyre personave bëhet edhe me rastin e shfaqjes së sëmundjeve ngjitëse në vendin e punës apo në familjet e tyre, si edhe kur për këtë gjë ekzistojnë indikacionet epidemiologjike që i konstaton organi kompetent i Inspektoratit Sanitar.

## Neni 26

26.1 Në prodhimin dhe në qarkullimin e artikujve ushqimorë ose në furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm nuk guxojnë të punojnë personat që vuajnë apo janë bartës të sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare të cilët mund të përhapin shkaktarët me artikuj ushqimorë, me ujë dhe me qelbëzim të lëkurës.

26.2 Në shkolla dhe në institucione të tjera për fëmijët dhe rininë nuk guxojnë të punojnë personat që vuajnë nga turbekulozi aktiv dhe janë bartës të streptokokut B-hemolitik të grupit A,

26.3 Në institucionet parashkollore për kujdesin e fëmijëve nuk guxojnë të punojnë personat që vuajnë nga turbekulozi aktiv, janë bartës të streptokokut B-hemolitik të grupit A dhe ata që tajojnë shkaktarë të sëmundjeve ngjitëse të zorrëve.

26.4 Në institucionet dhe në vendet e përcaktuara për ofrimin e kujdesit higjienik të popullsisë nuk guxojnë të punojnë personat që vuajnë nga turbekulozi aktiv, sëmundjet e qelbëzimit të lëkurës dhe sëmundjet parazitare.

26.5 Personat nga paragrafi 3 i këtij neni, nuk mund të punojnë në punët e caktuara, në qoftë se vuajnë nga tuberkulozi.

## Neni 27

27.1 Personat që kanë vuajtur nga tifoja e zorrëve, dizenteria bacilare, salmonellozat si dhe personat për të cilët dyshohet se janë mikrobbartës të këtyre sëmundjeve, i nënshtrohen kontrollit mjekësor gjithnjë derisa në bazë të analizës bakteriologjike të konstatohet se nuk janë mikrobbartës.

27.2 Personat të cilët janë bartës të antigjeneve të hepatiteve B dhe C e HIV-it duhet të marrin informata rigorozë profesionale për sjelljen dhe veprimet e tyre që të mos përhapin sëmundjen.

27.3 Personat që punojnë në prodhimin, qarkullimin dhe shpërndarjen e ushqimit duhet të posedojnë njohuri themelore për normat higjienike-sanitare dhe mbajtjen e higjienës personale.

27.4 Mënyra e marrjes së këtyre njohurive themelore është e rregulluar me akt nënligjor të Ministrisë së Shëndetësisë.

## Neni 28

### Imunoprofilaksa, seroprofilaksa dhe kimioprofilaksa

28.1 Vaksinoprofilaksa bëhet te:

- a) Vaksinimi është i obliguar ndaj këtyre sëmundjeve ngjitëse: tuberkulozit, hepatitit B, kollës së bardhë, difterisë, paralizës së fëmijëve, tetanosit, fruthit, parotitit dhe rubellës;
- b) Vaksinimit nga pika a) e këtij neni i nënshtrohen të gjithë fëmijët e Kosovës të moshës prej 0 ditëve deri në 19 vjeç, bazuar në kalendarin e vaksinimit;
- c) Nëse për çfarëdo arsye qoftë, nuk është kompletuar statusi vaksinal me kohë, ajo mund të fillohet/vazhdohet në çdo kohë pas konsultimit paraprak me mjekun familjar;
- d) Vaksinimi është i obliguar për të gjithë personat e kafshuar nga kafsha e tërbuar apo e dyshimtë në tërbim bazuar në doktrinën antirabike;
- e) Vaksinimi kundër tetanosit është i obliguar për të gjithë personat që kanë plagë tetanogjene bazuar në doktrinën antitetanike;

- f) Personat që udhëtojnë jashtë Kosovës dhe janë vatra endemike për sëmundje ngjitëse të caktuara duhet të vaksinohen me vakcina përkatëse varësisht nga situata epidemiologjike në atë vend;
- g) Popullata e Kosovës duhet të mbrohet me vakcina kundër sëmundjeve të caktuara ngjitëse varësisht nga situata epidemiologjike.

28.2 Hollësitë nga neni 28. paragrafi 1 pikat a) deri g) të këtij ligji, dhe detajet tjera do të përcaktohen me akt nënligjor.

#### Neni 29

Me miratimin e Ministrisë së Shëndetësisë, IKSHPK mban të drejtën e futjes së vaksinave të reja në kalendar të vaksinimit varësisht nga situata epidemiologjike.

#### Neni 30

Vaksinimin e bëjnë punëtorët shëndetësor me përgatitje të mesme apo të lartë mjekësore pas trajnimit paraprak dhe atë vetëm nën mbikëqyrje të mjekut përgjegjës.

#### Neni 31

31.1 Seroprofilaksës së obligueshme i nënshtrohen:

- a) Të gjithë personat e kafshuar nga kafsha e tërbuar apo e dyshimtë në tërbim bazuar në doktrinën kundër tërbimit;
- b) Të gjithë personat që kanë plagë tetanogjene bazuar në doktrinën kundër tetanosit;
- c) Të gjithë personat e kafshuar nga gjarpërinjtë.

31.2 Paragrafi 1 i këtij neni, rregullohet me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

#### Neni 32

32.1 Kimioprofilaksa/mbrojtja me barna është e obligueshme për të gjithë personat të cilëve iu kërcënohet rreziku për t'u infektuar nga këto sëmundje: kolera, dizenteria bacilare, malaria, tuberkulozi, meningjiti meningokoksik dhe anginës streptokoksike.

32.2 Paragrafi 1 i këtij neni rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.

### KARANTINA

#### Neni 33

33.1 Personat për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejt me personat e sëmurë apo të dyshimtë në sëmundje nga murtaja, variola dhe ethet hemorragjike virale futen në karantinë.

33.2 Kohëzgjatja e mbajtjes së personave nga paragrafi 1 i këtij neni, në karantinë varet nga periudha maksimale e inkubacionit të sëmundjes përkatëse;

33.3 Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, i nënshtrohen kontrollimeve mjekësore të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së karantinës;

33.4 Ministria e Shëndetësisë me propozim të IKSHPK merr vendim për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni;

33.5 Zbatimin e aktvendimit për futjen në karantinë të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, e sigurojnë organet kompetente në nivel të vendit.

#### MASAT TJERA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE

##### Neni 34

Në rast të një epidemie më të madhe, si dhe në raste të fatkeqësive natyrore, aksidenteve të rënda në miniera, komunikacion dhe në vend punishte, që mund të shkaktojnë sëmundje ngjitëse ose shpërthim epidemik, ku përfshihen një numër i madh qytetarësh, IKSHPK dhe ISK kanë për detyrë, që në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të ndërmarrin edhe këto masa për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse: mobilizimin e punëtorëve shëndetësorë dhe të qytetarëve të tjerë; furnizimin me pajisje, veshmbathje të posaçme, aparaturë përkatëse, medikamente dhe mjete të transportit; përdorimin e përkohshëm të lokaleve të punës dhe të lokaleve të tjera për dhënien e ndihmës shëndetësore; izolimin, mjekimin; si dhe caktimin e detyrave të posaçme për institucionet shëndetësore.

##### Neni 35

35.1 Nxjerrja nga varri dhe transportimi i personave të vdekur bëhet sipas mënyrës dhe sipas kushteve që e bëjnë të pamundshme përhapjen e epidemisë.

35.2 Transportimi i të vdekurve nga bota e jashtme në Kosovë dhe nga Kosova mund të bëhet vetëm me lejen e Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

35.3 Dispozita e paragrafit 2 të këtij neni, nuk ka të bëjë transportin e personave që nuk kanë vdekur nga sëmundjet ngjitëse dhe që nuk kanë qenë të varrosur.

##### Neni 36

36.1 Çdo person ka të drejtë t'i shfrytëzojë masat për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse të parashikuara me këtë ligj, ndërsa personat e sëmurë nga sëmundja ngjitëse kanë obligim që të mjekohen.

36.2 Çdo person dhe çdo institucion kanë për detyrë që t'i ndërmarrin dhe ti zbatojnë masat e caktuara dhe të urdhëruara nga organi kompetent për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse, në pajtim me ligjin.

##### Neni 37

37.1 Personi i sëmurë nga sëmundja ngjitëse ka për detyrë që t'i respektojë masat dhe udhëzimet e caktuara të institucioneve shëndetësore e cila i jep ndihmë mjekësore, sidomos lidhur me mbrojtjen e mjedisit të tij nga infeksioni.

37.2 Detyrë e posaçme e personit i cili vazhdimisht ose kohë pas kohe tajon bacilet e ndonjë sëmundjeje ngjitëse është që ti respektojë masat dhe udhëzimet e parashikuara që i cakton institucioni shëndetësore ose punëtori shëndetësisë.

#### Neni 38

Personi që udhëton në vendin ku ekziston kolera, murtaja, lija e madhe, ethet hemorragjike, SARS, gripi i shpendëve, ethet e verdha apo malaria, ose që kthehet nga vendi ku ekziston ndonjëra nga këto sëmundje, përveç masave dhe detyrimeve ka për detyrë ti plotësojë edhe kushtet e posaçme sanitare dhe kushtet të tjera të përfshira në këtë ligj.

#### Neni 39

39.1 Çdo institucion shëndetësor dhe çdo punëtor i shëndetësisë të cilit gjatë ushtrimit të veprimtarive të veta të rregullta zbulojnë sëmundje ngjitëse, kanë për detyrë të marrin masa të caktuara për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së mëtejme të infeksionit dhe masa më të domosdoshme kundër epidemike dhe higjienike që kushtëzohen nga natyra e sëmundjes si dhe të bëjnë analizat të personat e sëmurë dhe të personat e tjerë nga ambienti i tyre për mënyrën e mbrojtjes nga ky infeksion.

39.2 Çdo institucion shëndetësor ka për detyrë ti sigurojë kushtet sanitare dhe kushtet e tjera dhe të zbatojë masa përkatëse tekniko-sanitare, higjienike sanitare, organizative dhe përgjegjësit për mbrojtje nga infektimi brenda institucionit.

39.3 Çdo institucion shëndetësor, me aktin e vet të përgjithshëm, në përputhje me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, i përcakton masat, detyrimet dhe përgjegjësit për mbrojtjen nga infeksioni në vështrim të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

#### Neni 40

Çdo qytetarë, organizatë apo institucion tjetër kanë për detyrë që t'u mundësojnë organeve kompetente të administratës, institucioneve shëndetësore dhe punëtorëve të shëndetësisë që ti ushtrojnë kontrollet e paparashikuara sanitare të personave, kontrollet e ndërtesave dhe produkteve, të marrin material të nevojshëm për kontroll dhe të ndërmarrin masa të tjera të parashikuara, përkatësisht të caktuara për parandalimin ose për luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

### **Kapitulli IV**

#### **MASAT E SIGURISË PËR MBROJTJEN E POPULLSISË NGA SËMUNDJET NGJITËSE**

#### Neni 41

41.1 Për ta mbrojtur vendin nga kolera, murtaja, variola vera, ethet hemorragjike virale, ethet e verdha, SARS-i, gripi i shpendëve dhe sëmundjet tjera ngjitëse, merren masat e parashikuara me këtë ligj dhe me konventa ndërkombëtare sanitare dhe me akte tjera ndërkombëtare.

41.2 Për ta parandaluar futjen dhe përhapjen e kolerës, murtajës, variola vera, etheve hemorragjike virale, etheve të verdha, SARS-it, gripit të shpendëve dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse në tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë, me akte nënligjore përcakton masat e posaçme të jashtëzakonshme për mbrojtje nga këto sëmundje, si vijon:



- a) Ndalimi i udhëtimit në vendin ku është përhapur epidemia e ndonjëres nga këto sëmundje;
- b) Ndalimi i qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara;
- c) Kufizimi ose ndalimi i qarkullimit të llojeve të veçanta të mallrave dhe të produkteve;
- d) Pjesëmarrja e detyrueshme e institucioneve shëndetësore, institucioneve të tjera dhe e qytetarëve në luftimin e sëmundjes dhe në shfrytëzimin e objekteve, të pajisjes dhe të mjeteve të transportit me qëllim të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;

41.3 Për pjesëmarrjen në zbatimin e masave nga pikat a) deri d) të këtij neni, institucioneve shëndetësore, organizatave të tjera dhe qytetarëve u takon kompensimi adekuat nga organi kompetent.

#### Neni 42

42.1 Për ta mbrojtur vendin nga futja e sëmundjeve ngjitëse, organizohet dhe ushtrohet kontrolli sanitar i udhëtarëve dhe sendeve të tyre si dhe i mjeteve të transportit në qarkullimin ndërkombëtar që kryhet në kufinjet e Kosovës.

42.2 Kontrollin sanitar në kufi e ushtron inspektori sanitar në bazë të Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës Nr. 2003/22

#### Neni 43

Për zbatimin e kontrollit sanitar në kufi, neni 41 paragrafi 2 dhe neni 42 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, Inspektori Sanitar ka për obligim:

- a) Të urdhërojë kontrollin sanitar të personave dhe të materialeve për konstatimin e sëmundjeve ngjitëse;
- b) Të ndalojë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se mund të infektohen nga kolera, murtaja, variola vera, ethet hemorragjike virale, ethet e verdha, SARS-it dhe gripit të shpendëve;
- c) Të urdhërojë marrjen e masave të tjera të parashikuara tekniko- sanitare dhe higjienike kundër sëmundjeve ngjitëse, në përputhje me këtë ligj dhe me detyrimet në bazë të konventave ndërkombëtare sanitare dhe të traktateve të tjera ndërkombëtare.

#### Neni 44

Për zbatimin e kontrollit të parandalimit dhe të luftimit të sëmundjeve ngjitëse, organet e ISK-së përveç masave të theksuara në nenin 41 deri 43 të këtij ligji, kryen edhe këto detyra:

- a) Personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe të tajueseve të bacileve të këtyre sëmundjeve (mikrob-bartësve) t'ua ndalojë veprimtarinë në punë dhe në detyra të caktuara, përkatësisht në punët dhe në detyrat ku mund të rrezikojnë shëndetin e personave të tjerë;
- b) Të ndalojnë qarkullimin e personave për të cilët konstatohet ose dyshohet se janë të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse;
- c) Të ndalojnë tubimin e personave në shkolla, në kinema, në lokalet publike dhe në vendet e tjera publike, derisa të mos kalojnë rreziku nga epidemia;
- d) Të urdhërojnë dezinfektimin, dezinfektim dhe deratizimin me qëllim të parandalimit ose të luftimit të sëmundjeve ngjitëse;

- e) Të urdhërojnë izolimin e personave të sëmurë nga sëmundjet e caktuara ngjitëse dhe mjekimin e tyre;
- f) Të urdhërojnë marrjen e masave të tjera të përgjithshme ose të posaçme të parashikuara tekniko–sanitare dhe higjienike.

#### Neni 45

45.1 Masat nga nenet 41 deri 44 të këtij ligji, ndaj individëve dhe institucioneve urdhërohen me anë të aktvendimit me procedurë administrative.

45.2 Nëse Inspektori Sanitar me inspektim konstaton se ekziston indikacione epidemiologjike që kërkon të ndërmerren masa urgjente për evitimin e rrezikut për shëndetin e njeriut, urdhëron me gojë për zbatimin masave pa shtyrje të vendimit.

#### Neni 46

46.1 Organet e komunale shëndetësore kanë për detyrë që Ministrisë së Shëndetësisë t'i dërgojnë raportet lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe të dispozitave të miratuara në bazë të tij, si dhe të dhënat lidhur me shfaqjen dhe me masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

46.2 Administrata komunale e Inspektoratit Sanitar, ka për detyrë që të dërgoi raportet e punës dhe të dhënat lidhur me masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

46.3 Ministria e Shëndetësisë do të caktoi mënyrën dhe afatet e dërgimit të raporteve dhe të dhënave nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

#### Neni 47

47.1 Ministria e Shëndetësisë është kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe për miratimin e dispozitave të parapara me të.

47.2 Në përputhje me përgjegjësitë nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria e Shëndetësisë ka të drejtë dhe detyrë që:

- a) Organeve kompetente të administratës të Kosovës, t'i japi instruksionet e detyrueshme kur kjo është në interes të mbarë vendit dhe është e domosdoshme për aplikimin unik të dispozitave;
- b) Në qoftë se organi kompetent i administratës në Kosovë nuk e kryen një punë të caktuar administrative në bazë të autorizimit nga ky ligj, kurse moskryerja e kësaj pune mund të shkaktojë shfaqjen ose përhapjen e epidemisë së ndonjë sëmundje ngjitëse, nëpërmjet raportit Ministria e Shëndetësisë e njofton Qeverinë.

## Kapitulli V

### DISPOZITAT TJERA

#### Neni 48

Përveç të drejtave dhe detyrave të caktuara në nenet 41 deri 47 të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë:

- a) Ndjek ecurinë e sëmundjeve ngjitëse në vend dhe në botën e jashtme dhe lidhur me këtë njofton Qeverinë e Kosovës;
- b) Miraton programin dhe cakton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin;
- c) Organizon punën e organeve kompetente administrative, ministrive tjera që kyçen në çrrënjosjen e sëmundjeve të caktuara ngjitëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes nga sëmundjet ngjitëse-në rast epidemie që rrezikon tërë vendin.

#### Neni 49

Në kuadër të mbrojtjes së popullsisë nga sëmundjet ngjitëse që rrezikojnë tërë vendin, Qeveria e Kosovës, siguron mjete materiale shtesë për rastet emergjente:

- a) Për ushtrimin e kontrollit sanitar në kufijtë e Kosovës dhe për zbatimin e masave lidhur me ushtrimin e këtij kontrolli;
- b) Për mbulimin e shpenzimeve të izolimit, të ekzaminimit dhe të mjekimit të personave të sëmurë dhe të personave për të cilët dyshohet se vuajnë prej ndonjë nga këto sëmundje ngjitëse;
- c) Për mbulimin e shpenzimeve të karantinës dhe të kontrollit sanitar të personave që kanë qenë në kontakt me personat e sëmurë ose me personat për të cilët dyshohet se vuajnë prej ndonjë nga këto sëmundje ngjitëse;
- d) Për sigurimin e rezervave të nevojshme të vaksinave dhe të preparateve të tjera për parandalimin e përhapjes së këtyre sëmundjeve ngjitëse;
- e) Për imunizimin e popullsisë dhe për zbatimin e masave të tjera të luftimit të këtyre sëmundjeve, kur një gjë të këtillë urdhëron Ministria e Shëndetësisë.

#### Neni 50

Shërbimi Policor i Kosovës, në kuadër të të drejtave dhe të detyrave të veta bashkëpunon me organin kompetent Inspektoratin Sanitar të Kosovës, në bashkëpunim me IKSHPK kanë për detyrë t'i japin ndihmë në procedurën e kufizimit ose të ndalimit të udhëtimit në vendin ku mbizotëron epidemia e ndonjë lloji të sëmundjes ngjitëse, në procedurën e ndalimit, përkatësisht të kufizimit të qarkullimit të popullsisë në rajonin e infektuar në procedurën e kufizimit ose ndalimin e qarkullimit të llojeve të veçanta të artikujve ushqimor dhe me rastin e zbatimit të masave të tjera të parashikuara ose të urdhëruara në bazë të këtij ligji.

#### Neni 51

Ministria e Shëndetësisë, formon Komisionin për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse, si organ profesional dhe konsultativ, të përbërë nga ekspertë të fushave përkatëse, me propozim të IKSHPK-së.

## **Kapitulli VI**

### **FINANCIMI**

#### **Neni 52**

Financimi i aktiviteteve për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse realizohet sipas nenit 57. të Ligjit të Shëndetësisë.

## **Kapitulli VII**

### **DISPOZITA NDËSHKIMORE**

#### **Neni 53**

Për kundërvajtje administrative sanitare të parashikuara në bazë të këtij ligji, shqiptohen dënime me gjobë nga organet e Inspektoratit Sanitar të Kosovës, si vijon:

53.1 Personi fizik dënohet me gjobë prej 1.000€deri 2.000 €, kurse personi juridik me gjobë prej 3.000€deri 8.000€

- a) nëse konstaton dhe nuk paraqet sëmundjen, vdekjen nga sëmundja ngjitëse, epideminë, tajimin e shkaktarëve të sëmundjeve të caktuara ngjitëse, bartjen viruseve të hepatitit B dhe C, bartjen e virusit të HIV-it, bartjen e parazitëve të malarjes, lëndimin nga kafsha e tërbuar ose nga kafsha për të cilin dyshohet se është e tërbuar; në pajtim me nenin 13 të këtij ligji;
- b) nëse nuk e bën imunizimin, seroprofilaksën dhe kimioprofilaksën, në pajtim me nenet 28 deri 32, të këtij ligji;
- c) nëse nuk i merr masat e parashikuara për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së mëtejme të infeksionit ose masat e tjera më të domosdoshme kundërepidemike dhe higjienike që kushtëzohen nga natyra e sëmundjes;
- d) nëse nuk i cakton masat, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse dhe nuk i zbaton masat përkatëse tekniko-sanitare, higjienike dhe të tjera për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse.

53.2 Personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej 500€ deri 1.500€, për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### **Neni 54**

54.1 Personi fizik dënohet me gjobë prej 1.000€deri 2.000 €, kurse personi juridik me gjobë prej 3.000€deri 8.000€

- a) nëse nuk e zbaton masën e përgjithshme ose të posaçme për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse kur kjo është e domosdoshme në bazë të programit të organit kompetent ose kur nuk e zbaton atë brenda afatit të caktuar me këtë program;
- b) nëse nuk e kryen DDD e detyrueshme, sipas neneve 19 deri 23, të këtij ligji;
- c) nëse pranon në punë, përkatësisht mban në punë aktive personin për të cilin është konstatuar se lëngon nga sëmundja e caktuar ngjitëse ose tajon bacile të sëmundjes së tillë, ose nëse nuk siguron kontrollet periodike shëndetësore për personat që janë në punë e që ushtrojnë veprimtari të caktuara sipas nenit 26 dhe 27, të këtij ligji;

- d) nëse nuk ia bën të mundshme organit kompetent shëndetësorë, që t'i kryejë kontrollet e parashikuara të personave, të ndërtesave dhe të produkteve, ose të marrë materialin e nevojshëm për kontroll, me qëllim të parandalimit e të luftimit të sëmundjeve ngjitëse nga neni 38, i këtij ligji;
- e) nëse nuk vepron në bazë të aktvendimit të ekzekutueshëm të organit kompetent për punët e kontrollit sanitar me të cilin është dhënë urdhri për marrjen e masave të caktuara për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse sipas nenit 39 dhe 42, të këtij ligji.

54.2 Me gjobë prej 500€deri 1.500€për veprimin nga paragrafi 1 i këtij neni, do të dënohet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës në institucionin përkatës.

#### Neni 55

55.1 Personi fizik dënohet me gjobë prej 250€deri 1.000€ për kundërvajtje:

- a) nëse refuzon të hospitalizohet dhe izolohet në institucionin shëndetësor, përkatësisht në objektin e caktuar për këtë qëllim kur është sëmurë ose kur dyshohet se është sëmurë nga sëmundja e caktuar ngjitëse sipas nenit 17, të këtij ligji;
- b) nëse aplikon për punësim, përkatësisht vazhdon të punojë në mënyrë aktive ndonëse është informuar se lëngon nga sëmundja e caktuar ngjitëse apo se tajon shkaktarin e sëmundjes ngjitëse; ose në qoftë se nuk i përmbahet kontrolleve të obliguara shëndetësore për personat që kryejnë veprimtarin e caktuar sipas neneve 24 deri 27, të këtij ligji;
- c) nëse gjatë kohës së nën mbikëqyrjes shëndetësore, nuk i paraqitet çdo ditë institucionit të caktuar shëndetësor ose nëse nuk i nënshtrohet kontrolleve të nevojshme shëndetësore sipas nenit 34, të këtij ligji;
- d) nëse nxjerrë nga varri ose transporton personin e vdekur në mënyrën dhe kushtet që mund të përhapin sëmundjen ngjitëse, ose nëse bën transportin e kufomës pa leje të organit kompetent sipas nenit 35, të këtij ligji;
- e) nëse nuk i plotëson kushtet sanitare ose kushtet e tjera të caktuara me ligj, lidhu me udhëtimin në vendet ku ekzistojnë sëmundjet ngjitëse, sipas nenit 38, të këtij ligji;
- f) nëse nuk ia bën të mundshme organit kompetent, që të ushtrojë kontrollet e paparashikuara shëndetësore të personave ose kontrollin e objekteve ose të prodhimeve ushqimore, ose të marr materialin e nevojshëm për ta kontrolluar, ose të ndërmarr masa të tjera të parashikuara, përkatësisht të caktuara për parandalimin ose luftimin e sëmundjeve ngjitëse sipas nenit 40, të këtij ligji;
- g) nëse nuk vepron sipas aktvendimit të ekzekutueshëm të organit kompetent për punët e mbikëqyrjes sanitare, me të cilin është dhënë urdhër për marrjen e masave të caktuara për mbrojtjen nga sëmundjet ngjitëse sipas nenit 42 deri 45, të këtij ligji.

55.2 Me gjobë të parashikuara me këtë nen, dënohet prindi ose kujdestari kur vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 56

56.1 Personi fizik dënohet me gjobë prej 500€deri 1.000€ për kundërvajtje :

- a) nëse ushtron veprimtari të caktuar pa kontrollin paraprak sanitar ose në qoftë se refuzon që t'i nënshtrohet kontrollit sanitar gjatë ushtrimit të këtyre veprimtarive, ose në qoftë se me rastin e hyrjes në Kosovë refuzon t'i nënshtrohet kontrollit sanitar atëherë kur është i detyrueshëm që ta bëjë këtë, sipas neneve 24 deri 27, të këtij ligji;

b) nëse refuzon imunizimin, seroprofilaksën dhe kimioprofilaksën kundër sëmundjeve të caktuara ngjitëse, sipas neneve 28 deri 32, të këtij ligji.

56.2 Me gjobë të parashikuara me këtë nen, dënohet prindi ose kujdestari kur vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 57**

Kur shkelja e këtij ligji përbën veprë penale, dënohet sipas Kodit Penal, kapitulli XXI.

### **Kapitulli VIII**

#### **DISPOZITA KALIMTARE**

##### **Neni 58**

Ministria e Shëndetësisë, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes së këtij Ligji në fuqi, ka për detyrë të nxjerrë aktet nënligjore lidhur me masat, detyrimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e mbrojtjes dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

##### **Neni 59**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë rregulluar këtë fushë e të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

##### **Neni 60**

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-109**  
**10 maj 2007**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**

---

**Kolë Berisha**